

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E martë, 1 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11a	11b	11c	12a
Pikët														
Kërkesa	12b	12c	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20a	20b
Pikët														
Kërkesa	21a	21b	21c	22a	22b	23	24a	24b	25					
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**NAIM FRASHËRI****Bukuria**

Mos i hap leshratë n' erë
 Të m' arratiç mëndjen time,
 Mos më shiko dhe një herë,
 Se m' u bë zëmra thërrime.

Si thëllëz' e bukur mos shko,
 Mos vështro si pëllumbeshë,
 Shpirtinë mos ma përvëlo,
 Mos u tund si mbretëreshë.

Me qepallat si shtijë
 Mos më vra, mos më plagos,
 Me vështrim posi shkëndijë
 Mos më vdis e mos më sos.

E pashë dije tek shkonte,
 Soje ndrinte gjithë jeta,
 Pa hoth syt' e më shikonte.
 Duke kthyer si shigjeta.
 Posa pashë bukurinë,
 Zëmrën' e varfrë ma piku,
 Ndjeva në të dashurinë,
 Që më erth dhe më s' më iku.

Pse s' ka fjalë të dëftenjë
 Dashurin' e bukurinë
 Nuk' e them dot atë ndjenjë,
 Nuk' e them dot perëndinë.

Mos u mundo kot.
 Nukë thuhet dot.

M' iku me vrap djalëria
 E më la mbi dhe të shkretë,
 Më erth shtriga pleqëria
 Fshehtazi, si qen i qetë.
 Opopo, ç' më gjet, o shokë!
 Do të qanj me thes më kokë!

O ditët' e djalërisë,
 Që kishit shumë gëzime,
 Ratë në det t' arratisë,
 Më latë në hidhërimë.
 Tani jetën ç' e dua,
 Më s' është' e shkreta për mua!
 Ti o bukuroshja ime,
 Të ritë ma paç përjetë,
 Kurrë mos pafsh hidhërimë,
 Të dashtë zot' i vërtetë!
 Syri yt mos u venitë,
 Si hëna u përtëritë!

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Ky krijim i Naimit vjen te lexuesi si: **1 pikë**
- A) poemth
 - B) ode
 - C) elegji
 - D) ditiramb
2. Sipas Naimit bukuria lind: **1 pikë**
- A) dashurinë që të pushton përjetësisht
 - B) etjen për para dhe luks
 - C) dashurinë për miqtë që s'i kemi pranë
 - D) dëshirën për udhëtime ekzotike
3. Atmosfera e vargjeve në fund të fragmentit zotërohet nga: **1 pikë**
- A) dhimbja
 - B) lumturia
 - C) pamundësia
 - D) mahnitja
4. Fjala *Posa* që tregon momentin fillestar të takimit të poetit me të bukurën, i përket klasës së: **1 pikë**
- A) përemrit
 - B) ndajfoljes
 - C) mbiemrit
 - D) emrit
5. Autori e quan vashën, së cilës i drejtohet, *mbretëreshë* sepse: **1 pikë**
- A) ai është nën pushtetin e saj absolut
 - B) ai e neglizhon ndjenjën për të
 - C) ai e ndien veten mbret të saj
 - D) ajo është mbretëreshë e një mbretërie reale
6. Cili koment i shkon më për shtat krahasimit: *Si hëna u përtëritë!* **1 pikë**
- A) të bëhet e bukur sapo hëna të dalë
 - B) të ketë bukuri që nuk e vë re askush
 - C) të ketë bukuri përtëritëse dhe të përjetshme
 - D) të ngjajë me hënën, meqë ajo është e florinjte
7. Figura letrare e përdorur në vargjet: *Që më erth dhe më s'më iku*, është: **1 pikë**
- A) antitezë
 - B) paralelizëm
 - C) inversion
 - D) enumeracion

8. Ç'ndjenjë përftohet nga përsëritja e brendshme në strofën e tretë?
Pse përsëritet disa herë pjesëza *mos*? **2 pikë**

9. Identifikoni një tipar të poezisë popullore dhe një tipar të romantizmit, që i gjejmë në këtë krijim të Naimit. **2 pikë**

a) _____

b) _____

10. Ç' kumtojnë vargjet: *Ti o bukuroshja ime, / Të ritë ma paç përjetë*. Në ç' mënyrë është folja *paç*? **2 pikë**

a) _____

b) _____

11. Gjeni në fragment dy çifte vargjesh; një që formon rimë foljore dhe një që formon rimë emërore.

a) rima emërore: _____ **1 pikë**

b) rima foljore: _____ **1 pikë**

c) Ç' efekt krijojnë rimat e mësipërme? **1 pikë**

12. *Dashuria dhe Bukuria* përbëjnë boshtin kuptimor dhe artistik të ciklit *Bukuria*.

a) ç' raport krijojnë ato me konceptin *djalëri*? **1 pikë**

b) ç' raport krijojnë ato me konceptin *pleqëri*? **1 pikë**

c) Jepni dy detaje në strofën e fundit që realizojnë idenë e kohës pa kthim. **2 pikë**

PJESA II**SHEKSPIR****Makbethi (fragment)***(Hyn Makbethi dhe një shërbëtor me pishtar)***Bankoja**

Nëm shpatën, bir. Kush është atje?

Makbethi

Një mik

Bankoja

Si! S' paske rënë edhe? Mbreti fjeti.

Ish i gëzuar fort dhe daroviti

Të gjithë shërbëtorët e kështjellës.

Këtë diamant ia dhuron zonjës sate

Me falënderje për gostin' e bukur;

Dhe shkoi në shtrat pa masë i kënaqur.

Makbethi

Nuk ishim përgatitur për vizitën;

Rob' i mungesës ish vullneti ynë,

Se ndryshe do të shfaqej më lirisht.

Makbethi

O dhe, i ngjeshur hekur, themelfortë,

Mos i dëgjo ku më baresin këmbët

Se mos bërtasin ku po vete

Dhe ma rrëmbejnë kohën e favortë

Për veprën e tmerruar të tanishme.

Kur unë kërcënoj, ai po rron;

Me fjalë ftoh zjarr vepre që valon.

(tingëllon një zile)

Po shkoj, dhe është e bërë; zilja po më fton

Duncan, mos e dëgjo; se kjo kambanë

Po të thërret në qiell a ferrhapsanë. *(del)***Znj Makbeth**

Ajo q'ata i dehu ma forcoi kurajën,

Ajo q'i shoi ata ma ndezi zjarrin.

Hesht, hesht! Dëgjo!

Ish kukuvajka vajtimtare që na klithi

Dhe mvrojtur na uroi natën e mirë

Po i përvishet; dera është e çelur

Dhe shambellanët barkpërmbysur qesëndisin

Detyrën vigjëllore me gërritje;

Ua përzjeva me ilaç të pirat,

Sa vdekja dhe natyra po përleshën,

Se s'dihet vall' a rrojn'a kanë vdekur.

Makbethi (përbrenda)

Kush është atje? Ëh, eh!

Zonja Makbeth

Ajme! Kam frikë mos u zgjuan dhe s'u bë;

Përnisja dhe jo vepra na trondit më tepër.

Dëgjo! Gati ia lashë kamat të dyve;

Nuk është e mundur që të mos i ketë gjetur.

Sikur të mos i shëmbëllente babës

Kur flinte, do ta kisha bërë vetë.

Imzot! *(hyn Makbethi.)***Makbethi**

E bëra. Nuk dëgjove një shamatë?

Zonja Makbeth

Dëgjova kukuvajkën që këlthiste.

Mos the gjëkafshë?

Makbethi

Kur?

Zonja Makbeth

Tani.

Makbethi

Kur zbrisja?

Zonja Makbeth

Po.

Makbethi

Dëgjo! Kush fle n'odën e dytë?

Zonja Makbeth

Donalbani.

Makbeth*(duke shikuar duart.)* Kjo pamje ma vret

syrin.

Zonja Makbeth

Ç'më thua se ta vraka syrin!

Makbethi

Një qeshi n'ëndërr dhe një thirri: "Vrasje!"

Sa që të dy u zgjuan: ndenja dhe dëgjova;

U falën dhe i zuri prapë gjumi.

Për pyetjet nga 14 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.

14. Kryetema e Shekspirin në tragjedinë Makbeth është: **1 pikë**

- A) etja për pushtetin
- B) lakmia për pasuri
- C) urrejtja për pushtetin
- D) mirënjohja për mikun

15. Përgjigja: *Një mik*, në fillim të fragmentit dëshmon: **1 pikë**

- A) besnikërinë e Makbethit të njohur tashmë nga të gjithë
- B) se Makbethi është miku që Bankoja priste
- C) se Makbethi është armiku i vetëm në kështjellë
- D) thirrje për besim, që Makbethi ta ketë më të lehtë “veprën” e tij

16. Fjala: *themelfortë*, nga pikpamja e ndërtimit është fjalë: **1 pikë**

- A) e parme
- B) e përbërë
- C) e prejardhur
- D) e përngjitur

17. Mesazhi që përcjellin fjalët e Znj. Makbeth në vargun: *Përnisja dhe jo vepra na trondit më tepër*, është: **1 pikë**

- A) një punë kryhet mirë edhe kur nisja nuk është e tillë
- B) veprat e çdo lloji duhet të dominohen nga entuziazmi
- C) nuk ka rëndësi nëse një veper e çojmë deri në fund
- D) nuk na bën përshtypje krimi fillestar, por guximi për ta kryer atë

18. Paraqitjen skenike të tragjedisë e ndihmojnë: **1 pikë**

- A) dialogu dhe detajet
- B) përshkrimi dhe informacioni
- C) analiza dhe përmbledhja
- D) fakti dhe opinionin

19. Gjuha, me të cilën bashkëbisedojnë personazhet, është: **1 pikë**

- A) e qetë
- B) e tensionuar
- C) e trishtë
- D) solemne

20. a) Cilët nga personazhet në fragment pyesin: *Kush është atje?* **2 pikë**

b) Me ç’qëllim është përdorur pyetja nga secili personazh? **1 pikë**

21. Lexoni me vëmendje fjalët e Bankos në fillim të fragmentit, gjatë darkës.

a) Çfarë i dhuron mbreti Dunkan Znj. Makbeth? Përse?

2 pikë

b) Cili është grupi emëror, që tregon arsyen e dhuratës së çmuar?

1 pikë

c) Si është formuar ai?

1 pikë

22. Identifikoni dy foljet në vargun: *Një qeshi n'ëndërr dhe një thirri: "Vrasje!"*

Shpjegoni, brenda situatës, marrëdhënien kuptimore, që vendosin këto folje me njëra-tjetrën.

a) dy foljet:

2 pikë

b) shpjegoni marrëdhënien:

1 pikë

23. Kujt i drejtohet Makbethi në të vërtetë me anë të pasthirmës: *O dhe, i ngjeshur hekur, themelfortë,?*

1 pikë

24. Znj. Makbeth i drejtohet Makbethit: *Imzot.*

a) Tregoni pse ajo i drejtohet në këtë mënyrë?

1 pikë

b) Shpjegoni si e zbërthen Shekspiri anën psikologjike të Znj. Makbeth?

2 pikë

25. Përmendni dy veçori kompozicionale të tragjedisë Makbeth, që ju mund t'i ndeshni edhe në këtë fragment.

2 pikë

a) _____

b) _____